



REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVA - REPUBLIC OF KOSOVO
KËSHILLI GJYQËSOR I KOSOVËS - SUDSKI SAVET KOSOVA - KOSOVO JUDICIAL COUNCIL
PANELI ZGJEDHOR PËR ANKESA DHE PARASHTRESA
IZBORNI PANEL ZA ŽALBE I PREDSTAVKE - ELECTION COMPLAINTS AND APPEALS PANEL

ZL.Anr.42/2025

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa (PZAP), i përbërë nga gjyqtarët: Ramush Bardiqi - kryesues, Kujtim Pasuli dhe Hidajete Gashi Alaj - anëtarë, duke vendosur përkitazi me ankesën e subjektit politik Lëvizja Vetëvendosje (LVV), me seli në Prishtinë, të paraqitur kundër subjektit politik Partia Demokratike e Kosovës (PDK), me seli në Prishtinë, për shkak të pjesëmarrjes së klerikëve fetar dhe përdorimit të ndikimit fetar në fushatë zgjedhore për Zgjedhjet Lokale në Republikën e Kosovës që do të mbahen me datën 12 Tetor 2025, në seancën e panelit të mbajtur më 20.09.2025, merr këtë:

V E N D I M

Refuzohet e pa bazuar ankesa e subjektit politik, Lëvizja Vetëvendosje (LVV), me seli në Prishtinë, ZL.Anr.42/2025, e datës 17.09.2025, paraqitur kundër subjektit politik Partia Demokratike e Kosovës (PDK), me seli në Prishtinë, për shkak të pjesëmarrjes së klerikëve fetar dhe përdorimit të ndikimit fetar në fushatë zgjedhore për Zgjedhjet Lokale në Republikën e Kosovës që do të mbahen me datën 12 Tetor 2025.

A r s y e t i m

Me datën 17.09.2025, PZAP-i, ka pranuar ankesën e identifikuar me numër ZL.Anr.42/2025, nga subjekti politik Lëvizja Vetëvendosje (LVV) me seli në Prishtinë, me të cilën pretendon se më datë 16.09.2025, kandidati i PDK-së për kryetar të Komunës së Mitrovicës së bashku me kryetarin aktual nga e njëjta parti Bedri Hamza janë shfaqur në fotografi me një klerik fetar (hoxhë). Parashtruesi i ankesës thekson se sipas nenit 5 par. 2 pika 4 të Rregullës Zgjedhore 07/2024 për Fushatën e Zgjedhjeve, Monitorimin e Fushatës së Zgjedhjeve dhe Deklarimin Financiar, nuk lejohet përfshirja e të punësuarve në organizatat fetare. Parashtruesi i ankesës thekson se ky veprim përbën shkelje të barazisë në garë dhe përdorim të ndikimit fetar në fushatë zgjedhore, duke cenuar integritetin e procesit zgjedhor dhe kërkon nga PZAP-i të konstatoj shkeljen e bërë nga z. Tahiri dhe të i shqiptojë sanksionin sipas legjislacionit në fuqi. Si provë ka bashkangjitur një fotografi.

Në përgjigje në ankesë subjekti politik PDK thekson se kjo ankesë është tërësisht e pabazuar dhe e paargumentuar për arsyet se ankesa nuk e fotografia në fjalë nuk është publikuar as në profilin e z. Arian Tahiri, e as në atë të z. Bedri Hamzës. Andaj, e njëjta thekson se ankesa e LVV-së nuk paraqet asnjë fakt që dëshmon se fotografia është shpërndarë nga vetë kandidati

Arian Tahiri dhe se në rrethanat e rastit konkret, përmes këtyre veprimeve, PDK nuk është përgjegjëse për shkelje të ligjit, dhe kërkon që të refuzohet ankesa në fjalë.

Paneli pasi që shqyrtoj ankesën vlerësoi se:

-Ankesa është e pabazuar.

Paneli pas shikimit të shkresave të lëndës dhe përgjigjes në ankesë të paraqitur nga subjekti politik Partia Demokratike e Kosovës (PDK), vlerësoj se pretendimet e subjektit politik Lëvizja Vetëvendosje, janë të pa qëndrueshme dhe si të tilla i refuzoj për faktin se veprimet e përshkruara në ankesë, materiali i bashkangjitur me ankese nuk specifikon datën se kur është realizuar fotografia, pra Paneli nuk mund të pranoj një pretendim të tillë derisa ankuesi nuk ka dëshmuar se fotografia me përmbajtje të tillë, është realizuar gjatë fushatës zgjedhore

Rregulla Zgjedhore e KQZ-së Nr. 07/2024 për Fushatën e Zgjedhjeve, Monitorimin e Fushatës së Zgjedhjeve dhe Deklarimin Financiar, gjegjësisht nenin 5 par. 1 nën paragrafi 1.1 të, përcakton se: *Gjatë periudhës së fushatës zgjedhore, siç përcaktohet në nenin 44 të LZP-së, subjektet politike të certifikuara kanë të drejtë të organizojnë dhe mbajnë tubime-ngjarje politike, tryeza të rrumbullakëta, konferenca për shtyp, fjalime, ose ndonjë aktivitet tjetër të ngjashëm, përmes të cilave ata mund t'i shprehin lirisht mendimet e tyre me qëllim të fitimit të përkrahjes nga votuesit e tyre.* Ndërsa sipas nenit 5 par. 2 nën paragrafi 2.4 të kësaj rregullore përcaktohet se në fushatën e zgjedhjeve, nuk mund të përfshihen kategoritë e personave, si në vijim: *të punësuarit në organizatat bamirëse dhe fetare.*

Me nenin 117 paragrafi 3 i Ligjit Nr. 08/L-228 për Zgjedhjet e Përgjithshme në Republikën e Kosovës (LZP), në mënyrë decitive potencohet se *"Vendosja për ankesat nga PZAP-ja mbështetet në dëshmi të qarta dhe bindëse"*.

Andaj nisur nga dispozita e sipërcituara Paneli ka gjetur se pretendimet ankimore të parashtruesit të ankesës lidhur me shkeljen e pretenduar nga ana e subjektit politik Partia Demokratike e Kosovës (PDK), janë të pa qëndrueshme dhe si të tilla i refuzoj, për faktin se nga veprimet e përshkruara në ankesë dhe nga fotografia e ofruar si dëshmi nuk është vërtetuar është realizuar gjatë fushatës zgjedhore, për Zgjedhjet Lokale në Republikën e Kosovës që do të mbahen me datën 12 Tetor 2025. Në rrethanat e rastit konkret, Paneli vlerëson se ankuesi nuk ka dëshmuar me prova konkret se është mbajtur ndonjë tubim apo ndonjë ngjarje politike ose ndonjë aktivitet tjetër të ngjashëm e cila ka të bëjë me aktivitete të fushatës zgjedhore me të cilën do të shkeleshin rregullat zgjedhore. Andaj sipas vlerësimit të Panelit, nuk mund të vërtetohen pretendimet për të cilat theksohen në ankesë gjegjësisht se është mbajtur ndonjë tubim me karakter zgjedhor dhe se në të ka marrë pjesë apo është i përfshirë ndonjë klerik fetar.

Andaj paneli vlerëson se parashtruesi i ankesës në mbështetje të pretendimeve të tij, nuk ka ofruar dëshmi të qarta dhe bindëse dhe se pretendimet e tilla janë të paqëndrueshme, sipërfaqësore dhe jo e konkretizuar, andaj të njëjtën e refuzoi si të pabazuar, për faktin se nga veprimet e përshkruara në ankesë dhe nga provat e ofruara si dëshmi nga parashtruesi i ankesës

nuk është arritur që do të vërtetohej se ka pasur shkelje të dispozitave të Rregullës Zgjedhore të KQZ-së Nr.07/2024..

Nga arsyet e theksuara më lartë dhe duke u bazuar nenin 117 par. 3, lidhur me nenin 118 pa. 1 të LZP-së, u vendos si në dispozitiv të këtij vendimi.

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa
ZL.Anr.42/2025 datë 20.09.2025

Kryesues i Panelit
Ramush Bardiqi



Këshillë Juridike: Kundër këtij vendimi është e lejuar ankesa sipas nenit 118 paragrafi 4 të LZP-së, në Gjykata Supreme të Kosovë, brenda 48 orëve nga momenti i marrjes-pranimet të këtij vendimi.